



---

## **EKSTRAKT I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së pestë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 29.09.2016,  
e cila filloi në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** Halim Halimi, kryesues i Kuvendit, Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Dardan Sejdiu, nënkryetar, këshilltarët e Kuvendit: Hazir Borovci (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Naime Osmani (LDK), Hasime Krasniqi (LDK), Flamur Shala (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Sokol Krasniqi (LDK), Shaip Hajrizi (LDK), Muhamet Nura (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Vjollca Dibra - Ibrahimimi (LDK), Besa Rafuna (LDK), Shiqeri Spahiu (LDK), Ajnishahe Azemi (LDK), Merita Surkishi (LDK), Fisnik Osmani, (LDK), Qëndron Kastrati, shef i GP-së (LVV), Sylejman Pireva (LVV), Hatixhe Hoxha (LVV), Genc Sherifi (LVV), Teuta Krasniqi (LVV), Bardha Dida - Rogova (LVV), Hatixhe Latifi - Pupovci (LVV), Ylli Hoxha (LVV), Kreshnik Ahmeti (LVV), Sadri Ramabaja (LVV), Lirak Çelaj, shef i GP-së (PDK), Blerand Stavileci (PDK), Shemsi Veseli (PDK), Lirie Avdiu (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Laura Zherka (PDK), Shaip Shabani (PDK), Mirlinda Sopi, shefe e GP-së (AKR), Sami Boroci, (AKR), Sofije Bunjaku (AKR), Remzi Pacolli (AKR), Brahim Mehmetaj, shef i GP-së (AAK-LDD), Imer Rusinovci (AAK-LDD), Rita Begolli (AAK-LDD), Fadil Gashi (AAK-LDD), Feti Mehdiu, shef i GP-së (PD), Kimet Zeqa (PD), Abetare Fazliu, përfaqësues e subjektit politik (LB), Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik PF, Nenad Miladinoviqi, përfaqësues i subjektit politik GIS, Cuneyd Ustaibo përfaqësues i subjektit (KDTP) dhe Abit Kastrati.

**Mungoi:** Lirijeta Rexhepi (PDK).

**Të pranishëm** ishin edhe përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të KFOR-it dhe përfaqësues të OSBE-së.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues.  
Ai hapi diskutimin për rendin e ditës.

**Qëndron Kastrati**, propozoi që pika e dytë e rendit të ditës “*Betimi i anëtarit të ri të Kuvendit*”, të jetë pikë e parë e rendit të ditës.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua propozimi i z. Kastrati, që betimi i anëtarit të ri të Kuvendit të jetë pikë e parë e rendit të ditës.**

**Brahim Mehmetaj** propozoi që pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës “*Raportimi i Komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike*”, të jetë pikë e dytë e rendit të ditës), me arsyetimin se në mbledhjen e kaluar është ndërprerë kjo pikë për diskutim.

**Për rendin e ditës diskutuan edhe:** Agim Gashi, Qëndron Kastrati, Lirak Çelaj, Fadil Gashi, Sylejman Pireva, Shefki Gashi, Visar Arifaj, Shaip Hajrizi, Kimet Zeqa, Mirlinda Sopi, Hazir Boroci, Feti Mehdiu dhe Shiqeri Spahiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**Kryesuesi** e hodhi në votim propozimin e z. Brahim Mehmetaj.

**Kryesuesi** konstatoi se, me 25 (njëzet e pesë) vota për dhe 26 (njëzet e gjashtë) vota kundër, (Halim Halimi me të drejtë vote të dyfishtë, Hazir Borovci, Fisnik Osmani, Vlora Dumoshi, Agim Gashi, Shefki Gashi, Mustafë Krasniqi, Shaip Hajrizi, Sokol Krasniqi, Muhamet Nura, Naime Osmani, Vjollca Dibra-Ibrahimi, Ajnishahe Azemi, Hasime Krasniqi, Merita Surkishi, Flamur Shala, Shiqeri Spahiu, Besa Rafuna, Lirak Çelaj, Blerand Stavileci, Shaip Shabani, Muhamet Selmani, Lirie Avdiu, Laura Zherka dhe Shemsi Veseli), nuk kaloi propozimi që pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës të kalojë si pikë e tretë e rendit të ditës.

**Kryesuesi** e hodhi në votim rendin e ditës dhe konstatoi se, me 26 (njëzet e gjashtë) vota për dhe 25 (njëzet e pesë) vota kundër, ( Qëndron Kastrati, Hatixhe Hoxha, Ylli Hoxha, Hatixhe Latifi - Pupovci, Teuta Krasniqi, Genc Sherifi, Sylejman Pireva, Sadri Ramabaja, Kreshnik Ahmeti, Bardha Dida-Rogova, Sami Boroci, Mirlinda Sopi, Sofije Bunjaku, Remzi Pacolli, Rita Begolli, Imer Rusinovci, Fadil Gashi, Brahim Mehmetaj, Abetare Fazliu, Feti Mehdiu, Kimet Zeqa, Visar Arifaj, Nenad Miladinoviqi, Abit Kastrati dhe Cuneyd Ustaibo), u miratua rendi i ditës, ashtu si është propozuar.

**Kryesuesi konstatoi se u miratua ky**

#### **Rendi i ditës:**

- 1. Betimi i anëtarit të ri të Kuvendit;**
- 2. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së tretë dhe të katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;**
- 3. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;**

4. Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2017 dhe të Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2017-2019;
5. Propozimrregullorja për tatimin e pronës së paluajtshme;
6. Propozimrregullorja për menaxhimin e mbeturinave;
7. Plani për menaxhimin e mbeturinave 2016-2020;
8. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Zyrës së Bashkimit Evropian;
9. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë;
10. Propozimvendimi për anulimin e Aktvendimit, 07 nr. 463-651/98, të dt.19.09.1998, të Komisionit për Kthimin e Tokave të Kuvendit të Qytetit të Prishtinës;
11. Raportimi i komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike;
12. Pyetje dhe përgjigje;
13. Të ndryshme.

#### **Pika e parë**

**Betimi i anëtarit të ri të Kuvendit.**

**Fisnik Osmani** bëri betimin para anëtarëve të Kuvendit.

#### **Pika e dytë**

**Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të mbledhjes së tretë dhe të katërt të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.**

**Bardha Dida - Rogova** bëri vërejtje në ekstraktin e procesverbalit të mbledhjes së tretë, në pikën "Pyetje dhe përgjigje", duke thënë se emri i saj nuk është shkruar drejt, andaj duhet të jetë: Bardha Dida - Rogova.

**Me vërejtjen e dhënë, me 31 (tridhjetë e një) vota për, 3 (tri) vota kundër (Mirlinda Sopi, Sami Boroci, Sofije Bunjaku) dhe 11 (njëmbëdhjetë) abstenime, (Kreshnik Ahmeti, Besa Rafuna, Blerand Stavileci, Fadil Gashi, Flamur Shala, Hatixhe Hoxha, Imer Rusinovci, Laura Zherka, Lirak Çelaj, Muhamet Nura dhe Shiqeri Spahiu), u miratuan ekstraktet e procesverbaleve të mbledhjes së tretë dhe të katërt të Kuvendit.**

#### **Pika e tretë**

**Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.**

**Kryesuesi konstatoi se, me 31 (tridhjetë e një) vota për, 4 (katër) vota kundër (Cuneyd Ustaibo, Shiqeri Spahiu, Sylejman Pireva, Teuta Krasniqi) dhe 9 (nëntë) abstenime, (Bardha Dida - Rogova, Hatixhe Hoxha, Kreshnik Ahmeti, Ylli Hoxha, Abetare Fazliu, Fadil Gashi, Nenad Miladinoviqi, Rita Begolli dhe Sadri Ramabaja ), u miratua**

## **Vendimi për ndryshimin e Vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.**

### **Pika e katërt**

#### **Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2017 dhe të Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën kohore 2017-2019.**

#### **Kryesuesi hapi diskutimin.**

Për këtë pikë diskutuan: Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Agim Gashi, shef i GP të LDK-së, Qëndron Kastrati, shef i GP të LVV-së, Muhamet Selmani, në emër të GP të PDK-së, Imer Rusinovci, në emër të GP të AAK-së, Feti Mehdiu, shef i GP të PD-së, Abetare Fazliu, përfaqësuese e subjektit politik LB, Visar Arifaj, përfaqësues i subjektit politik PF, Nenad Miladinoviç, përfaqësues i subjektit politik GIS, Blerand Stavileci, Flamur Shala, Lirak Çelaj, Kimet Zeqa, Hasime Krasniqi, Naime Osmani, Lirie Avdiu, Bardha Dida - Rogova, Vlora Dumoshi, Shiqeri Spahiu, Merita Surkishi, Shefki Gashi, Shemsi Veseli, Kreshnik Ahmeti, Sadri Ramabaja, Ylli Hoxha, Mustafë Krasniqi, Hazir Borovci, Sami Boroci, Sylejman Pireva, Arben Vitia, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Bardha Dida - Rogova, Besart Vllahinja, drejtori i Drejtorisë së Kulturës dhe Dardan Sejdiu, nënkryetar, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**Mirlinda Sopi**, shefe e GP të AKR-së, kërkoi të dijë se cila është arsyeja që në projektin e paraparë të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, në projektbuxhetin e Komunës për vitin 2017, është ndërruar emri i një projekti, nga "Qendra për qëndrim ditor të personave me aftësi të kufizuara", në "Qendrën e qëndrimit ditor për personat me sindrom daun dhe autizëm".

**Ajnishahe Azemi** kërkoi të dijë se përse është hequr projekti për ndërtimin e Qendrës për qëndrim ditor për persona me nevoja të veçanta, dhe në vend të tij është vendosur projekti për Qendrën për sindrom daun dhe autizëm. Në emër të GP të LDK-së, kërkoi kthimin e menjëhershëm të projektit për ndërtimin e Qendrës për qëndrim ditor për personat me nevoja të veçanta.

**Me propozimet e dhëna, që në buxhet të parashihet projekti për ndërtimin e Qendrës për qëndrim ditor për persona me nevoja të veçanta, me 40 (dyzet) vota për, 3 (tri) vota kundër, (Agim Gashi, Muhamet Selmani, Shiqeri Spahiu) dhe 4 (katër) abstenime, (Muhamet Nura, Sokol Krasniqi, Ajnishahe Azemi, Laura Zherka), u miratua Vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2017 dhe të Kornizës afatmesme buxhetore për periudhën 2017-2019.**

## **Pika e pestë**

### **Propozimrregullorja për tatimin e pronës së paluajtshme.**

Për këtë pikë diskutuan: Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës, Sokol Krasniqi, Qëndron Kastrati, Lirak Çelaj, Mirlinda Sopi, Brahim Mehmetaj, Feti Mehdiu, Visar Arifaj, Cuneyd Ustaibo, Nenad Miladinoviq, Ylli Hoxha, Shefki Gashi, Agim Gashi, Kimet Zeqa, Ardian Olluri, shef i Zyrës ligjore, Shemsi Veseli dhe Sadri Ramabaja, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**Kryesuesi konstatoi se, me 20 (njëzet) vota për, 18 (tetëmbëdhjetë) vota kundër, (Agim Gashi, Ajnishahe Azemi, Brahim Mehmetaj, Fisnik Osmani, Hazir Borovci, Imer Rusinovci, Lirak Çelaj, Lirie Avdiu, Muhamet Nura, Muhamet Selmani, Mustafë Krasniqi, Naime Osmani, Rita Begolli, Shaip Hajrizi, Shefki Gashi, Shemsi Veseli, Shiqeri Spahiu, Ylli Hoxha) dhe 1 (një) abstenim, (Merita Surkishi), u miratua Rregullorja për tatim në pronën e paluajtshme.**

## **Pika e gjashtë**

### **Propozimrregullorja për menaxhimin e mbeturinave.**

Lidhur me këtë propozimrregullore diskutuan: Merita Surkishi, Ardian Olluri, shef i Zyrës ligjore, Agim Gashi, Gent Begolli, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Kreshnik Ahmeti, Muhamet Selmani, Remzi Pacolli, Brahim Mehmetaj, Feti Mehdiu, Visar Arifaj, Cuneyd Ustaibo, Nenad Miladinoviqi, Qëndron Kastrati dhe Ajnishahe Azemi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**Kryesuesi konstatoi se, me 35 (tridhjetë e pesë) vota për, 2 (dy) vota kundër, (Lirak Çelaj, Shiqeri Spahiu) dhe 1 (një) abstenim, ( Merita Surkishi), u miratua Rregullorja për menaxhimin e mbeturinave**

## **Pika e shtatë**

### **Plani për menaxhimin e mbeturinave 2016 - 2020.**

**Agim Gashi** propozoi që të futet në objektiv një deponi për grumbullimin e mbeturinave komunale ose familjare (pasi që nuk grumbullohen në të gjitha vendbanimet) në territorin e komunës së Prishtinës.

Për këtë pikë diskutuan edhe: Kreshnik Ahmeti, Lirak Çelaj, Mirlinda Sopi, Brahim Mehmetaj, Visar Arifaj, Cuneyt Ustaibo dhe Nenad Miladinoviqi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**Me propozimin e z. Agim Gashi, me 31 (tridhjetë e një) vota për, 2 (dy) vota kundër, (Shefki Gashi, Shiqeri Spahiu) dhe 2 (dy) abstenime (Merita Surkishi, Brahim Mehmetaj), u miratua Plani për menaxhimin e mbeturinave 2016-2020.**

#### **Pika e tetë**

**Propozimvendimi për dhënien e pronës se paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Zyrës së Bashkimit Evropian.**

Për këtë pikë diskutuan: Dardan Sejdiu, nënkryetar, Ylli Hoxha, Brahim Mehmetaj, Muhamet Selmani, Visar Arifaj, Agim Gashi, Lirak Çelaj, Feti Mehdiu, Ardian Olluri shef i Zyres ligjore, dhe Sadri Ramabaja, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**Kryesuesi konstatoi se, me 30 (tridhjetë) vota për, 7 (shtatë) vota kundër, (Cuneyd Ustaibo, Hatixhe Hoxha, Kreshnik Ahmeti, Qëndron Kastrati, Shiqeri Spahiu, Sylejman Pireva, Teuta Krasniqi) dhe 2 (dy) abstenime, (Kimet Zeqa, Visar Arifaj), u miratua Vendimi për dhënien e pronës se paluajtshme të Komunës së Prishtinës në shfrytëzim Zyrës së Bashkimit Evropian.**

#### **Pika e nëntë**

**Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë.**

Për këtë pikë diskutua: Shiqeri Spahiu, Qëndron Kastrati, Lirak Çelaj, Mirlinda Sopi, Rita Begolli, Visar Arifaj dhe Ardian Olluri, shef i Zyres ligjore, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**Kryesuesi konstatoi se, me 33 (tridhjetë e tri) vota për, 2 (dy) vota kundër, (Shefki Gashi, Shiqeri Spahiu) dhe 1 (një) abstenim, (Muhamet Nura), u miratua Vendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës me pronën e paluajtshme në pronësi të personave fizikë.**

#### **Pika e dhjetë**

**Propozimvendimi për anulimin e Aktvendimit, 07 nr.463-651/98, dt. 19.09.1998, të Komisionit për Kthimin e Tokave të Kuvendit të Qytetit të Prishtinës.**

Lidhur me këtë propozimvendim, z. **Shpend Ahmeti**, Kryetar i Komunës, i njoftoi të pranishmit në pika të shkurtra, duke cekur se ky propozimvendim ka të bëjë me një kompensim financiar, që ka qenë në vlerën prej 9.5 milionë euro, për një vendim të vitit 1998, andaj dhe është hapur një kontest gjyqësor, për çka ne kemi bërë padi për anulimin e vendimit si të paligjshëm.

Për këtë pikë diskutuan edhe: Ardian Olluri, shef i Zyrës ligjore, Lirak Çelaj, Shemsi Veseli dhe Shefki Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**Me propozimin e Kryetarit, kryesuesi konstatoi se Propozimvendimi për anulimin e Aktvendimit, 07 nr.463-651/98, dt. 19.09.1998, të Komisionit për Kthimin e Tokave të Kuvendit të Qytetit të Prishtinës, tërhiqet nga diskutimi dhe nuk shqyrtohet.**

#### **Pika e njëmbëdhjetë**

**Raportimi i komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike.**

Lidhur me raportimin e komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike, diskutuan: Agim Gashi, Qëndron Kastrati, Lirak Çelaj, Mirlinda Sopi, Brahim Mehmetaj, Feti Mehdiu, Abetare Fazliu, Visar Arifaj, Cuneyt Ustaibo, Nenad Miladinoviqi, Shaip Hajrizi, Muhamet Selmani, Shemsi Veseli, Dardan Sejdiu, nënkryetar, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

*Pas një debati mes anëtarëve të Kuvendit, GP i LDK-së, GP i PDK-së dhe kryesuesi i Kuvendit e lëshuan mbledhjen.*

*Vazhdimin e mbledhjes e kryesoi anëtari më i vjetër i Kuvendit z. Feti Mehdiu.*

Për situatën e krijuar gjatë mbledhjes, konkretisht rreth debatit lidhur me pikën e njëmbëdhjetë “Raportimi i komisioneve të aksionarëve të ndërmarrjeve publike”, diskutuan: Dardan Sejdiu, nënkryetar, Feti Mehdiu, kryesues, Brahim Mehmetaj, Abit Kastrati, Qëndron Kastrati dhe Sylejman Pireva, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

**Kryesuesi konstatoi se në mungesë të kuorumit, mbledhja nuk mund të vazhdojë.**

**Mbledhja përfundoi në orën 18:15.**

**Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit  
Halim Halimi, jur. i dipl.**